



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 77, Datë 29.04.2024

MBI

**HEQJEN E PEZULLIMIT TË VENDOSUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.
32, DATË 27.03.2024 DHE LICENCIMIN E SHOQËRISË
“DRINI BULQIZE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 130/23 prot., datë 26.04.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 32, datë 27.03.2024 dhe licencimin e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 32, datë 27.03.2024, ka vendosur:
 1. Të pezullojë vendimmarrjen e tij mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, deri kur të depozitohet në ERE:
 - a) Leja e rinovuar e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie nga HEC “Polemi”.
 - b) Qëndrimi përfundimtar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me vlefshmërinë e kontratës nr.119 Rep 61/1 Kol., datë 24.01.2018, “Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e HEC “Polemi” me kapacitet prodhues 1.751MW”.
 - c) Shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, datë 27.02.2024, në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
 - d) Vërtetimi që shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
 2. Ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të depozitimit të secilit prej dokumenteve të përcaktuara në pikën 1.

- ERE ka njoftuar për këtë vendimmarrje shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. me shkresën nr. 130/19 prot., datë 05.04.2024, duke vënë në dijeni MIE-n dhe AMBU-në.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 130/20 prot., datë 18.04.2024 dhe nr. 130/22 prot., datë 26.04.2024, shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. ka depozituar në ERE informacion/dokumentacion plotësues referuar vendimit nr. 32/2024.
- Nga analiza e bërë e të gjithë dokumentacionit të këtij aplikimi, rezulton si vijon:
 - Shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. (në cilësinë e mbajtësit të miratimit), ka nënshkruar me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MIE) *Kontratën për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e HEC “Polemi” me kapacitet prodhues 1.751MW*, me nr. 119 Rep., nr. 61/1 Kol., datë 24.01.2018. Neni 3 i Kontratës, tregon karakteristikat e hidrocentralit, me 3 vepra marrjeje dhe fuqi të instaluar 1751 kW.
 - ERE i është drejtuar MIE-s me shkresën nr. 130/10 prot., datë 05.02.2024, me kërkesën për informacion/qëndrim, në lidhje me vlefshmërinë e Kontratës me nr. 119 Rep., nr. 61/1 Kol., datë 24.01.2018, referuar dhe sa përcaktuar në raportin e AKBN-së, mbi testimin e kryer më datë 11.01.2024, në lidhje me mospërmbushjet e detyrimeve të kësaj kontrate, duke qenë se nga grupi i testimin është konstatuar shtimi i një veprë marrjeje, që nuk rezulton në projektin e miratuar.
 - Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/17 prot., datë 20.03.2024, MIE ka kërkuar nga ana e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. përgjigjen me argumentet bindëse në lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e shoqërisë për sa bërë me dije nga AKBN-ja.
 - Shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k., me shkresën e datës 18.04.2024, ka vënë në dispozicion të ERE-s një kopje të shpjegimeve që i ka nisur MIE-s dhe AKBN-së, ku ndër të tjera, shoqëria pretendon se nuk ka marrë përgjigje përfundimtare zyrtare për miratimin e ndryshimit të afatit të përfundimit të punimeve dhe të ndryshimit të projektit të zbatimit si dhe pranon se ka pasur disa shkelje në kushtet kontraktuale, por duke analizuar sipas saj, të gjithë faktorët përmbledhës dhe vështirësitë e ndeshura, i ka dhënë shtetit shqiptar një objekt të konsoliduar dhe jetëgjatë.
 - Për gjithë sa më sipër dhe për sa përcaktuar në kushtin pezullues të vendimit të bordit të ERE-s nr. 32/2024, nuk rezulton që nga MIE të jetë depozituar ndonjë qëndrim apo vendim në lidhje me shpalljen e pavlefshme të Kontratës nr. 119 rep., nr. 61/1 kol., datë 24.01.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC “Polemi” me kapacitet prodhues 1.751 MW”, si e tillë kjo është një kontratë në fuqi.
- Në këto rrethana vlerësohet heqja e pezullimit referuar këtij kushti dhe marrja e një vendimi përfundimtar nga ana e ERE-s për licencimin e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të kontratës nr. 119 rep., 61/1 kol., datë 24.01.2018 dhe të gjitha lejeve/miratimeve të tjera të depozituara për qëllime të këtij aplikimi, për kapacitetin e instaluar 1.751 MW, duke marrë në konsideratë që nga vetë shoqëria është bërë me dije (Shtojca 2), se numri i njësisive gjeneruese është 1. ERE ruan të drejtën për të rishikuar këtë vendim në rast se depozitohet një qëndrim i ndryshëm i MIE-s.
- Shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. është e pajisur me lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor nr. 261 prot., datë 17.04.2024, me nr. serial 000139, miratuar me vendimin e e Këshillit të Basenit Ujqor Shkumbin nr. 07, datë 11.04.2024, për shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k., për përdorimin e burimit për prodhim hidroenergjie nga HEC “Polemi”

- me afat 5-vjeçar, pra deri më 17.04.2029 duke qenë se afati i lejes nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, vlerësohet që t'i lihet kusht asaj që të depozitohet në ERE Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së saj (brenda datës 17.04.2029). Në rast se shoqëria nuk e depoziton këtë leje brenda afatit dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria është pajisur me Vendim për VNM PARAPRAKE, me nr. 859 prot., datë 05.04.2017, vendim nr. 14, me nr. Identifikimi 222, për subjektin “DRINI BULQIZE” sh.p.k., për fuqinë e instaluar 1.753 kW, për të zhvilluar projektin “HEC Polemi”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit Zalli i Neshtës, Librazhd, Qarku Elbasan. Me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nr. 1225/3 prot., datë 05.07.2018, drejtuar shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. është korigjuar fuqia e instaluar (e cila është bërë 1751 kW, sikurse rezulton dhe nga Kontrata me MIE-n) evidentohet se ky *vendim është i vlefshëm deri më 04.04.2019.*
 - Për sa më sipër dhe duke qenë se hidrocentrali është ndërtuar tashmë, ERE me shkresën nr. 130/9 prot., datë 05.02.2024, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), duke kërkuar informacion/qëndrimin e saj në rast se punimet e këtij hidrocentrali kanë filluar brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake.
 - Në përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/14 prot., datë 16.02.2024, AKM ka informuar ERE-n se *nga verifikimi i bazës së të dhënave rezulton se ka dorëzuar raport monitorimi për periudhën Korrik 2019-Janar 2020, administruar dhe shqyrtuar nga Sektori i Përgjegjësisë Mjedisore. Subjekti “Drini Bulqizë” është inspektuar nga ISHMPUT me Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000367 - 5, Datë: 19/08/2019 dhe nuk rezulton të ketë shkelje të kërkesave ligjore.*
 - Shoqëria është pajisur me miratimin e pikës së lidhjes, sipas shkresës së OSSHE sh.a., nr. 13100/3 prot., datë 23.05.2017, “Miratim pikë lidhje HEC “Polemi”, me fuqi të instaluar 1.750 MW.
 - Po ashtu, rezulton që shoqëria ka plotëduar dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, gërmat “c” dhe “d”, të vendimit nr. 32/2024.
 - Në nenin 4 të Kontratës nr. 119 rep., nr. 61/1 kol., datë 24.01.2018 përcaktohet se kohëzgjatja e kontratës do të jetë 49 (dyzet e nëntë) vjet, nga data e hyrjes në fuqi së saj, me të drejtë ripërsëritje sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni.
 - ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret, nga përlllogaritja e afateve të kontratës me MIE-n rezulton se afati i mbetur është 43 vjet, por ERE kushtëzohet nga parashikimet ligjore në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, për 30 vjet.
 - Për gjithë sa më sipër, vlerësohet të hiqet pezullimi i vendosur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 32/2024 dhe të vijohet me marrjen e vendimit përfundimtar për licencimin e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Polemi, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi

tre degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 32, datë 27.03.2024.
2. Të licencojë shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.
3. Shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. duhet të depozitohet në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Polemi” brenda datës 17.04.2029.
4. Në rast se shoqëria nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, sikurse përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrijë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të depozitimit të dokumentacionit përkatës në referencë të kushteve të vendosura në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të një qëndrimi të ndryshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me vlefshmërinë e kontratës nr.119 Rep 61/1 Kol., datë 24.01.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC “Polemi”, me kapacitet prodhues 1.751MW”.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI